



## MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE Republika e Shqipërisë – Zgjedhjet Parlamentare, 25 qershor 2017

### DEKLARATË E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

#### PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit u zhvilluan pas një marrëveshjeje politike midis kryetarëve të Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD), e cila siguroi pjesëmarrjen e opozitës. Garuesit zgjedhor ishin në gjendje të bënin lirshëm fushatë dhe liritë themelore u respektuan. Zbatimi i marrëveshjes politike krijoi sfida për administrimin e zgjedhjeve dhe rezultoi në një zbatim selektiv dhe të paqëndrueshëm të ligjit. Politizimi i vazhdueshëm i organeve dhe institucioneve të lidhura me zgjedhjet, si dhe akuzat e gjera për blerjen e votave dhe presionin ndaj zgjedhësve, uli besimin e publikut në procesin zgjedhor. Në një ditë zgjedhjesh përgjithësisht të rregullt, në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit të vëzhguara procedurat e rëndësishme nuk u respektuan plotësisht. Ka pasur vonesa në numërim në shumë zona.

Zgjedhjet u zhvilluan në kontekstin e një hendeku të gjatë dhe të thellë politike, midis PS-së të koalicionit qeverisës dhe PD-së të opozitës, si edhe besimit të ulët publik në procesin zgjedhor. Në një zhvillim pozitiv, më 18 maj u arrit një marrëveshje politike e ndërmjetësuar ndërkombëtarisht mes kryetarëve të PS-së dhe PD-së, e cila i dha fund një ngërçi tre mujor dhe i dha mundësinë PD-së për të emëruar individë të saj në poste kyçe ministore, duke përfshirë një zëvendëskryeministër, dhe drejtues të institucioneve të tjera.

Kuadri ligjor siguron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, megjithëse shumë rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës nuk janë adresuar, duke përfshirë nevojën për depolitizimin e aspekteve kyçe të administratës zgjedhore. Ndryshimet ligjore, pas marrëveshjes politike, kishin për qëllim të përmirësonin mbikëqyrjen e financimit të fushatës dhe të siguronin reklamën pa pagesë në të gjitha mediat audiovizive. Mënyra e zbatimit demonstroi prioritetin e interesave politike mbi respektimin e sundimit të ligjit. Futja e vonshme e ndryshimeve ligjore dhe mungesa e konsultimeve publike kuptimplotë sfidoi sigurinë ligjore dhe ndikoi negativisht në administrimin e disa komponentëve zgjedhorë, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) veprroi në mënyrë transparente me seanca të rregullta publike. Pas marrëveshjes politike, KQZ-ja dhe administrata e saj u përballën me një sërë problemesh ligjore, institucionale, financiare dhe administrative. Përkundër kësaj, KQZ-ja zbatoi detyrat kryesore të saj. Megjithatë, KQZ-ja nuk mori masa për të sqaruar mospërputhjet që lidhen me legjislacionin e sapondryshuar dhe disa nga vendimet e saj nuk ishin të qëndrueshme apo ligjërish të shëndosha. Formimi i komisioneve zgjedhore të nivelit më të ulët u përfundua shumë kohë pas afatit ligjor për shkak të emërimit të vonuar të komisionerëve nga partitë. Kjo, së bashku me numrin e madh të zëvendësimeve, nënkuptonte që një pjesë e madhe e administratës zgjedhor nuk ishin të trajnuar. Në tërësi, kjo ka ulur efikasitetin e administratës zgjedhore.

Regjistrimi i zgjedhësve është pasiv dhe në përgjithësi nuk janë ngritur çështje të rëndësishme lidhur me saktësinë e listave të zgjedhësve nga bashkëbiseduesit e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ). Publikimi i vonuar i listave përfundimtare të zgjedhësve dhe dërgimi jo i vazhdueshëm i njoftimeve tek zgjedhësit, kanë kufizuar shqyrtimin publik të listave të zgjedhësve.

Kufizimet në regjistrimin e zgjedhësve në lidhje me moshën dhe paaftësinë mendore janë në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.

KQZ-ja regjistroi 15 parti politike brenda afatit ligjor, ndërsa tre parti të tjera opozitare u regjistruan pas afatit kohor në bazë të marrëveshjes politike. Në të njëjtën kohë, dy garuesëve të tjerë të mundshëm u është mohuar regjistrimi për shkak të propozimeve të vonuar. Procesi i regjistrimit të kandidatëve, edhe pse gjithëpërfshirës, vuajti nga zbatimi selektiv dhe jo i qëndrueshëm i ligjit, dhe në disa raste ishte i bazuar më shumë në marrëveshjen politike sesa në ligj.

Fushata paraqiti një shumëllojshmëri të opsioneve politike. Liritë themelore të tubimit dhe shprehjes janë respektuar. Fushata ishte e rëndësishme në të gjithë vendin, edhe pse përdorimi i posterave të madhësive të mëdha dhe flamujve ishte i kufizuar për shkak të ndryshimeve të fundit ligjore. Fushata u karakterizua nga akuza të përhapura për blerjen e votave, shqetësimet mbi keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe presionet ndaj zgjedhësve lidhur me vendin e punës, duke ulur më tej besimin e publikut.

Gratë ishin aktive, por të nënpërfaqësuar në fushatë. Disa aktivitete kishin në shënjestër veçanërisht gratë zgjedhëse. Në mesin e kandidatëve rreth 40 përqind ishin gra. Megjithatë, partitë më të mëdha politike nuk respektuan gjithmonë kuotat gjinore në listat e tyre të kandidatëve dhe kandidatet gra morën pak vëmendje nga mediat. Gratë, gjithashtu ishin të nënpërfaqësuar në administratën zgjedhore, duke përfshirë edhe pozicionet vendimmarrëse.

Legjislacioni i ndryshuar kontribuoi në transparencën dhe llogaridhënien e financimit të fushatës, duke adresuar disa rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe Këshillit të Evropës. Masat e reja për të ulur kostot e fushatës janë mirëpritur nga shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së. Transparenca u zvogëlua nga mungesa e kërkesave për dhënien e informacioneve shpjeguese para ditës së zgjedhjeve.

Mediat i ofruan elektoratit një mbulim të gjerë të fushatës, duke u ofruar zgjedhësve një gamë të gjerë opinionesh politike. Megjithatë, mediat ofruan një qasje të kufizuar analitike. Garuesëve u është ofruar mundësia për të marrë pjesë në debate, por asnjë debat nuk u zhvillua mes liderëve të partive kryesore. Nga monitorimi i medias i kryer nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it rezultoi se të gjitha kanalet televizive të monitoruara u fokusuan kryesisht në aktivitetet e tri partive më të mëdha. Transmetuesi publik u pajtua me detyrimin ligjor për të siguruar kohë proporcionale pa pagesë për partitë.

Në përgjithësi, pakicave kombëtare iu ofruan mundësi të barabarta për të marrë pjesë në zgjedhje, si kandidatë dhe si zgjedhës, duke përfshirë përdorimin e gjuhës së tyre amtare. KQZ-ja ka ofruar disa materiale për edukimin e zgjedhësve në gjuhët e pakicave. Megjithatë, disa bashkëbisedues të MNVZ-së ngritën shqetësime specifike rreth përpjekjeve për blerjen e votave në zonat me popullsi të lartë Rome dhe Egjiptiane.

Kodi Zgjedhor parashikon një procedurë ankimore administrative kundër vendimeve të komisioneve të nivelit më të ulët dhe ankesat gjyqësore kundër vendimeve të KQZ-së. Megjithatë, përgjegjësia për trajtimin e ankesave për shkeljet e rregulloreve të fushatës ishte e paqartë. Qëndrimi i kufizuar për të sjellë ankesa kundër vendimeve të KQZ-së mund të lërë aktorët e prekur pa një mbrojtje ligjore. Një numër i kufizuar i apelimeve u bënë para ditës së zgjedhjeve në Kolegjin Zgjedhor, i cili respektoi afatin për shqyrtimin e ankesave. Janë respektuar të drejtat procedurale të palëve dhe vendimet e Kolegjit janë arsyetuar, edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme.

Ligji parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar në të gjitha fazat e zgjedhjeve. Në një hap pozitiv, KQZ-ja detyroi komisionet e nivelit më të ulët të afishojnë publikisht protokollet e rezultateve të numërimit, duke shtuar transparencën. Akreditimi i vëzhguesve ishte gjithëpërfshirës.

Dita e zgjedhjeve ka vijuar kryesisht në një mënyrë të rregullt, por janë vërejtur parregullsi procedurale kyçe dhe mosveprime. Kjo përfshin procedurat e paqëndrueshme për verifikimet e markimit me bojë, rastet e votimit në emër të personave të tjerë dhe në grup, si dhe ndërhyrjen e aktivistëve të paautorizuar të partive. Janë vërejtur shqetësime rreth kërcënimeve të mundshme nga grupet e aktivistëve të partive brenda dhe rreth qendrave të votimit. Procesi i numërimit u vonua në shumë zona. Procedurat e numërimit nuk janë ndjekur gjithmonë dhe transparenca nuk u garantua gjithmonë. KQZ-ja raporti 45 për qind pjesëmarrje në votim.

Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet pjesërisht nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave ose apeliemeve të mundshme.

---

## GJETJET PARAPRAKE

---

### Konteksti

Më 5 dhjetor 2016, Presidenti thirri zgjedhjet parlamentare të 18 qershorit 2017.<sup>1</sup> Më 7 shkurt, PD-ja nisi një bojkot parlamentar dhe zhvilloi protesta publike, duke pretenduar se Qeveria e drejtuar nga PS-ja nuk mund të garantonte zgjedhje të besueshme. PD-ja dhe aletatët e saj nuk u regjistruan fillimisht për zgjedhjet duke bërë thirrje për dorëheqjen e Kryeministrit, formimin e një qeverie teknike dhe futjen e votimit elektronik. PS-ja i hodhi poshtë këto kërkesa dhe pretendoi se PD-ja nuk donte të merrte pjesë në zgjedhje, për shkak të mungesës së mbështetjes popullore.

Pas ndërmjetësimeve intensive ndërkombëtare, ngërçi përfundoi më 18 maj me një marrëveshje politike të arritur mes kryetarëve të PD-së dhe PS-së.<sup>2</sup> Marrëveshja siguroi pjesëmarrjen e PD-së dhe aleatëve të saj në zgjedhje dhe i dha mundësinë PD-së të caktojë individë të saj në disa poste kyçe, duke përfshirë një zëvendëskryeministër, gjashtë ministra, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), drejtorët e disa agjensive publike dhe Avokatin e Popullit.<sup>3</sup> Më 21 maj, në përputhje me marrëveshjen, Presidenti shtyu zgjedhjet më datë 25 qershor.

Pas marrëveshjes politike, Qeveria ngriti një Task Forcë ministrore, të kryesuar nga zëvendëskryeministri i ri, me qëllimin e deklaruar, për të shmangur keqpërdorimin e burimeve shtetërore për zgjedhjet. Megjithatë, efektiviteti i saj u zvogëluar nga konfliktet ndërmjet ministrave të emëruar nga PD-ja dhe përfaqësuesve të PS-së nga administrata shtetërore.

Marrëveshja politike u mirëprit gjërësisht. Megjithatë, disa bashkëbisedues të MNVZ-së pretenduan ekzistencën e disa pjesëve të pazbuluara të marrëveshjes, që sipas tyre ishin në dëm të garuesëve të tjerë.

---

<sup>1</sup> Si rezultat i zgjedhjeve të fundit parlamentare, të 2013-ës, Aleanca për Shqipërinë Europiane mori 83 mandate parlamentare, duke përfshirë Partinë Socialiste (PS, 65 mandate), Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI, 16 mandate), Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ, 1 mandat) dhe Partia Kristian Demokrate (PKD, 1 mandat). Aleanca për Punë, Prosperitet dhe Integrim mori 57 mandate, duke përfshirë Partinë Demokratike (PD, 50 mandate); Partinë Republikane të Shqipërisë (PR, 3 mandate), Partinë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU, 4 mandate).

<sup>2</sup> Marrëveshja politike u botua në faqet e internetit të [PD-së](#) dhe [PS-së](#). Ajo përmban vazhdimin e procesit të reformës gjyqësore dhe zgjedhore, futjen e votimit elektronik në zgjedhjet e ardhshme dhe institucionalizimin e dialogut midis dy kryetarëve të partive.

<sup>3</sup> Parlamenti, shkarkoi nga detyra Avokatin e Popullit dhe emëroi një të ri më 22 maj, duke mos respektuar procesin e përcaktuar ligjor. Avokati i ri i Popullit, u betua vetëm më 17 qershor, duke lënë institucionin e të drejtave të njeriut pa udhëheqje për pjesën më të madhe të periudhës zgjedhore.

## Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor

Të 140 deputetët e Kuvendit zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare në një sistem proporcional me anë të listave të mbyllura përfaqësimi, në 12 zona zgjedhore shumëemërore që i korrespondojnë qarqeve administrative të vendit.<sup>4</sup> Për t'u kualifikuar për ndarjen e mandateve, partitë duhet të kalojnë prapë prapë tre përqind të votave të hedhura në qarkun përkatës.

Kuadri ligjor për zgjedhjet parlamentare konsiston në Kushtetutën e 1998-ës, Kodin Zgjedhor të 2008-ës, dhe legjislationet e tjera<sup>5</sup>. Ndërkohë që Kodi Zgjedhor siguron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, mangësitë e identifikuar në raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it nuk u adresuan përpara këtyre zgjedhjeve. Kjo përfshinte rekomandime lidhur me forcimin e kuotës gjinore, sigurimin e pavarësisë së administratës zgjedhore, rritjen e transparencës së financimit të fushatës dhe qartësimin e përgjegjësisë për ankesat zgjedhore.<sup>6</sup> Mungesa e qartësisë së disa dispozitave të Kodit Zgjedhor ndikoi negativisht në procesin zgjedhor.<sup>7</sup>

Më 22 maj, u miratuan ndryshime në ligjin "Për Partitë Politike", ligjin "Për Mediat Audio-vizive" dhe në Kodin Penal. Ndryshimet, paraqitën kërkesa të reja për fushatën, financimin e fushatës dhe transmetimin e reklamave në mediat elektronike, si dhe përcaktimin e disa krimeve si krime të reja zgjedhore dhe rritjen e sanksioneve për ato ekzistuese.<sup>8</sup> Thelbi i ndryshimeve u përshëndet nga shumë bashkëbisedues të MNVZ-së dhe disa nga amendimet morën si referencë rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien e financimit të fushatës dhe masa më të vendosura për të parandaluar presionin ndaj punonjësve të sektorit publik dhe praktikantët e korruptuara zgjedhore.

Megjithatë, mënyra e zbatimit demonstroi prioritetin e interesave politike ndaj respektimit të sundimit të ligjit, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës, procesit pasues i mungonte transparenca dhe konsultim me grupet e interesit, ndërsa vonesa në kohë krijoi vështirësi të mëdha në zbatimin e aspekteve kyçe të administrimit zgjedhor.<sup>9</sup> Për më tepër, bërja efektive e marrëveshjes politike pa ndryshuar Kodin Zgjedhor e dëmtoi qëndrueshmërinë e kuadrit ligjor, duke sfiduar sigurinë ligjore.<sup>10</sup> Në tërësi, kjo nënvizon nevojën për një reformë zgjedhore të vazhdueshme gjithëpërfshirëse, në kohë, dhe të bazuar në analiza politike të shëndosha.

<sup>4</sup> Më 3 dhjetor 2016, në bazë të të dhënave të popullsisë nga Ministria e Brendshme (MB), KQZ-ja caktoi numrin e mandateve për çdo qark, duke filluar nga 3 në Kukës në 34 në Tiranë. Parlamenti miratoi ndarjen e mandateve më 20 prill, rreth pesë javë pas afatit ligjor.

<sup>5</sup> Duke përfshirë ligjin "Për Partitë Politike" të vitit 2000, ligjin "Për tubimet" të vitit 2001, ligjin "Për Mediat Audiovizive" të vitit 2013, ligjin "Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose ushtrojnë Funkcione Publike" (ligji "Për Dekriminalizimin"), ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" i vitit 2008, dhe dispozitatat përkatëse të Kodit Penal.

<sup>6</sup> Shiko [të gjitha raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it mbi Shqipërinë](#).

<sup>7</sup> Për shembull, kërkesa që "zyrtarët e lartë" të administratës publike duhet të japin dorëheqjen para se të kandidojnë (neni 63.4) është e paqartë, sepse zyrtarët e tillë nuk janë të identifikuar qartë në ligj; kuptimi i "shumicës qeverisëse" (neni 95.2) për qëllimet e emërimit të anëtarëve të grupit të numërimit është i paqartë dhe është kontestuar nga LSI në gjykatë. (Shiko *Ankesat dhe Apelimet*)

<sup>8</sup> Veprat e reja penale përfshijnë abuzimin me funksionin publik për aktivitetet zgjedhore, përdorimin e dokumenteve të identifikimit të personave të tjerë dhe ndalimet më të detajuara për shit-blerjen e votave.

<sup>9</sup> Paragrafi 5.8 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, i detyron shtetet pjesëmarrëse të miratojnë legjislationin e miratuar "në fund të një procedure publike". Seksioni II.2.b i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës në vitin 2002 rekomandon që "elementet themelore të ligjit zgjedhor ... nuk duhet të jenë të hapura për amendim më pak se një vit përpara zgjedhjeve".

<sup>10</sup> Sipas Kushtetutës, Kodet kanë peshë më të madhe ligjore si akte të miratuara me shumicë të cilësuar të votave (neni 81). Shiko gjithashtu vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut 2002 në *Podkolzina v. Letonisë*, paragrafi 35.

## Administrimi i Zgjedhjeve

Zgjedhjet administrohen nga një sistem administrimi me tre nivele: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 90 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), dhe 5,362 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Votat do të numërohen nga Grupet e Numërimit (GN) në 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV). Komisionet e zgjedhjeve në të gjitha nivelet kanë 7 anëtarë të emëruar nga shumica parlamentare dhe opozita. Vetëm KQZ është një organ i përhershëm, i cili është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Gratë janë të nënpërfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore, sidomos në pozicionet vendimmarrëse.<sup>11</sup>

Pas marrëveshjes politike, KQZ u përball me një sërë sfidash ligjore, institucionale dhe financiare, nën kufizime të shumta kohore.<sup>12</sup> Si pjesë e marrëveshjes, Parlamenti zëvendësoi kryetarin e KQZ-së 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve me një anëtar tjetër të KQZ-së, i cili përfaqëson opozitën, duke anashkaluar procedurën e përcaktuar me ligj.<sup>13</sup> Nevoja për të rimiruar vendimet e mëparshme të miratuara para ndryshimit të datës së zgjedhjeve dhe për të miratuar rregullore të reja, ngarkuan më shumë KQZ-në dhe administratën e saj.<sup>14</sup>

Pavarësisht nga këto kufizime, KQZ-ja zbatoi detyrat e saj kryesore dhe ishte e gatshme të jepte informacion, vepronte në mënyrë të hapur, me sesione publike të transmetuara drejtpërsëdrejti në internet, dhe me pjesëmarrjen e rregullt të vëzhguesve, mediave dhe përfaqësuesve të partive. Megjithatë, KQZ-ja, nuk ka marrë masa për të sqaruar mospërputhjet që kanë të bëjnë me reklamimin e fushatës në median audiovizive. Emërimi i anëtarëve të KZAZ-ve nuk i ka respektuar gjithmonë kriteret e papajtueshmërisë të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.<sup>15</sup> Për më tepër, KQZ-ja tregoi një qasje jo të qëndrueshme gjatë regjistrimit të kandidatëve dhe vendosjen e sanksioneve për shkeljet e kuotës gjinore në listat e kandidatëve. Gjithsesi, kjo ngriti shqetësime lidhur me efektivitetin e KQZ-së dhe qëndrueshmërinë e vendimeve të saj, duke ulur besimin e publikut në administratën zgjedhore.

Formimi i komisioneve të niveleve më të ulëta ishte problematik dhe përfundoi pas afatit ligjor. Partitë e opozitës nuk pranuan të emërojnë anëtarët e KZAZ-ve brenda afatit fillestar. Prandaj KQZ-ja formoi KZAZ-të me vetëm katër anëtarë dhe sekretarin, duke nxitur aplikimet nga qytetarët me të drejtë vote, ashtu siç kërkohet nga ligji. Pas marrëveshjes politike, partitë e opozitës patën mundësi të emëronin anëtarët përsëri, por vonuan më tej emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve dhe një numër i madh i anëtarëve të KZAZ-ve rrjedhimisht u zëvendësuan.<sup>16</sup> Asnjë nga 90-të KZAZ-të nuk mundi të formojë KQV-të dhe grupet e numërimit brenda afatit ligjor.<sup>17</sup> Rreth 720 KQV nuk ishin formuar deri më 23 qershor.

<sup>11</sup> Dy nga shtatë anëtarët e KQZ-së dhe rreth një e treta e anëtarëve të KZAZ-ve janë gra (rreth 20 përqind në poste drejtuese të KZAZ-ve). Vetëm 21 përqind e anëtarëve në KQV-të e vëzhguara ditën e zgjedhjeve ishin gra, dhe 18 përqind e këtyre KQV-ve drejtoheshin nga gratë.

<sup>12</sup> KQZ mori 10 milionë lekë (rreth 74,000 euro, 1 euro është rreth 135 lekë) nga qeveria, të cilat së bashku me buxhetin rezervë të KQZ-së duhej të shpenzoheshin për ekspertë të rinj të monitorimit të financimit të fushatës.

<sup>13</sup> Me ligj, kryetari i KQZ-së emërohet nga parlamenti nëpërmjet një procesi të hapur aplikimi.

<sup>14</sup> Për shembull, rregulloret për monitorimin e financimit të fushatës, sqarimet e rregullave të reja të fushatës, dhe formularin tip.

<sup>15</sup> Deputetët, kandidatët, kryetarët e bashkive, ushtarakët, policët dhe stafi i shërbimit të sigurisë si dhe anëtarët ose sekretarët e një komisioni tjetër nuk mund të shërbejnë në KZAZ. Megjithatë, për shembull, në KZAZ-në 3, 48 dhe 87 kishte anëtarë dhe sekretarë të regjistruar si kandidatë nga PDS-ja, LSI-ja dhe PS-ja.

<sup>16</sup> KQZ përfundoi formimin e KZAZ-ve, pasi PR-ja paraqiti kandidatët e mbetur më 16 qershor. Që prej 24 qershorit, 118 nga 720 anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve u zëvendësuan, kryesisht për shkak të kërkesave për emërim të partive. Ky bie në kundërshtim me paragrafin 2.3.1.f të Kodit të praktikës së Mirë për Çështjet zgjedhore të Komisionit të Venecias të 2002, i cili thekson që (institucionet të cilat emërojnë anëtarë të komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lirë për t'i pushuara ata sipas dëshirës).

<sup>17</sup> Më 13, 15, 19 dhe 21 qershor, KQZ-ja bëri deklaratë që u bënin thirrje partive politike të emëronin anëtarët e KQV-së.

MNVZ-ja u informua se partitë vonuan emërimin për shkak të shqetësimeve rreth korrupsionit të mundshëm të komisionerëve nga kundërshtarët e tyre, duke reflektuar mosbesim të thellë mes partive politike. Emërimet e vonuara janë përdorur gjithashtu për të anashkaluar ndalimin ligjor për zëvendësimin e anëtarëve të KQV-së.<sup>18</sup> Ky është tregues i dobësisë sistematike të një administrate zgjedhore shumë të politizuar.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vizitoi 83 KZAZ përpara ditës së zgjedhjeve dhe vuri re se disa nuk kishin ambiente dhe pajisje të përshtatshme, ndërsa të tjerë raportuan se nuk kishin fondet e nevojshme për të administruar zgjedhjet në kohën e duhur dhe duhej të vepronin me fondet personale të anëtarëve të tyre.<sup>19</sup> Përfaqësuesit e disa prej administratave vendore, nuk i lejuan punonjësit të përmbushnin funksionet si anëtarë KZAZ-je, duke pretenduar se nëpunësit civilë nuk duhet të angazhohen në aktivitete politike, në kundërshtim me deklaratat e KQZ-së.<sup>20</sup>

KQZ-ja ofroi trajnime për anëtarët e KZAZ-ve, të cilat MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i vlerësoi për pjesëmarrje të mirë por të ndryshme në cilësi. Ndërsa, disa trajnime ishin interaktive dhe të mirëorganizuar, zhvillimi i të tjerave u krye dobët dhe u mungonin materialet e trajnimit. KQZ-ja organizoi trajnimet e KQV-ve prej 17 deri më 22 qershor, ndërsa KZAZ-të ishin ende në procesin e formimit të KQV-ve, duke ndikuar negativisht në efektivitetin e tyre. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi se këto trajnime nuk u kryen ose kishin pjesëmarrje të dobët.

Fushata KQZ-së për regjistrimin e votuesve mbuloi procedurat e ditës së zgjedhjeve, përgjegjësinë lidhur me shkeljet zgjedhore dhe informacionin që dekurajon votimin familjar. Disa spote televizive u mbështetën nga gjuha e shenjave. Sidoqoftë, informacioni për zgjedhësit u vonua ndjeshëm dhe ishte me shikueshmëri të kufizuar.

## Regjistrimi i Zgjedhësve

Qytetarët shqiptarë të moshës 18 vjeç e lart në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë. Kufizimet në të drejtën e votës së qytetarëve të gjetur të paaftë mendërisht me vendim të gjykatës sfidojnë detyrimet ndërkombëtare, të cilat ndalojnë diskriminimin në bazë të një paaftësie.<sup>21</sup> E drejta për të votuar është hequr për ata që vuajnë një dënim me burg për kryerjen e krimeve të caktuara.<sup>22</sup>

Sistemi i regjistrimit të votuesve është pasiv. Në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së, votuesit mbi 100 vjeç janë hequr automatikisht nga listat e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë të dhënat e tyre për t'u ripërfshirë.<sup>23</sup> Zgjedhësit janë të përfshirë në listën e zgjedhësve të QV-ve që ndodhet në vendin e tyre të banimit dhe mund të votojnë vetëm atje pa patur mundësi për të votuar nga jashtë vendit, me

<sup>18</sup> Kodi Zgjedhor nuk lejon partitë politike të tërheqin kandidatët e tyre të KQV-ve.

<sup>19</sup> Për shembull, KZAZ-të 12, 15, 43, 52, 53 dhe 78-90.

<sup>20</sup> MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori raporte të tilla nga Berati, Kukesi dhe Shkodra. Në deklaratat publike të 27 majit dhe 10 qershorit, KQZ sqaroi se punësimi në administratën publike lokale nuk binte në kundërshtim me anëtarësimin në komisionet zgjedhore dhe bëri i thirrte drejtuesve të administratës lokale që t'i jepnin leje komisionerëve.

<sup>21</sup> Shiko nenet 12 dhe 29 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) të 2006-ës. Shih gjithashtu, paragrafi 9.4 Komitetit të Komunikimit të KDPAK -së për vitin 2013, Nr. 4/2011 (Zsolt Bujdosó dhe të tjerët kundër Hungarisë) i cili deklaroi se: "Neni 29 nuk parashikon ndonjë kufizim të arsyeshëm dhe as nuk lejon ndonjë përjashtim për çdo grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi nga e drejta për të votuar në bazë të një paaftësie të perceptuar ose aktuale psikosociale ose intelektuale, duke përfshirë një kufizim në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar".

<sup>22</sup> Ligji "Mbi Dekriminalizimin" ka futur kufizime mbi të drejtat e votimit të qytetarëve që vuajnë dënimin me burg për kryerjen e krimeve të renditura në rreth 60 nene të Kodit Penal. MVZ i OSBE / ODIHR u informua se e drejta e votës iu pezulluan 1,371 personave.

<sup>23</sup> Paragrafi 5.9 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 thotë: "Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtjen e barabartë të ligjit pa asnjë diskriminim". Shiko, gjithashtu nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Sipas DPGJC, 1,480 votues mbi moshën 100 vjeç u hoqën nga listat e zgjedhësve nga dhjetori 2016 deri në 24 maj 2017, nga të cilat 271 ri-konfirmuan të dhënat e tyre.

postë ose nëpërmjet kutisë së lëvizshme të votimit.<sup>24</sup> Që prej 24 qershorit, numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,452,260.<sup>25</sup>

Listat e zgjedhësve nxirren nga baza elektronike e të dhënave të mbajtura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të Ministrisë së Brendshme (DPGJC). Pas dekretimit të ditës së zgjedhjeve, DPGJC publikoi ekstrakte të përditësuara të listave të zgjedhësve në baza mujore, duke u lejuar zgjedhëve të regjistrojnë ndonjë ndryshim në zyrat lokale të gjendjes civile.<sup>26</sup> Zgjedhësit gjithashtu mund të kontrollojnë të dhënat e tyre në faqen e internetit të KQZ-së. Në janar 2017, KQZ-ja caktoi dy auditues për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve të cilët vërejtën disa adresa me të dhëna të pasakta. Asnjë çështje domethënëse në lidhje me saktësinë e listave të zgjedhësve nuk është ngritur nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, me përjashtim të pengesave për zgjedhësit nga komuniteti Rom (shiko *Pjesëmarrjen e Pakicave Kombëtare*).

Listat përfundimtare të zgjedhësve në lidhje me datën fillestare të zgjedhjeve të 18 qershorit janë printuar dhe afishuar në QV-të nga KZAZ-të përkatëse. Pas ndryshimit të datës së zgjedhjeve, u hartuan dhe printuan listat e reja të zgjedhësve për të përfshirë zgjedhësit që do të mbushnin 18 vjeç deri më 25 qershor. Megjithatë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri në dukje se në shumicën e vëzhgimeve, listat e reja të zgjedhësve nuk u afishuan në QV-të apo u afishuan vonë. Bashkive u kërkohet të njoftojnë zgjedhësit për QV-në e tyre përkatëse, por disa bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it deklaruan se këto njoftime nuk janë shpërndarë gjithmonë.<sup>27</sup> KQZ-së i duhej të ndryshonte vendndodhjen e 435 QV-ve dhe vazhdoi ta bënte këtë deri në ditën e zgjedhjeve.<sup>28</sup> Ndryshimet e vonshme të vendndodhjes së QV-ve, publikimi i vonuar i listave përfundimtare të zgjedhësve dhe shpërndarja jo e qëndrueshme e njoftimeve të zgjedhësve, kanë kufizuar shqyrtimin publik të listave të zgjedhësve.

## Regjistrimi i Kandidatëve

Çdo zgjedhës me të drejtë vote mund të jetë kandidat për zgjedhjet, përveç atyre të cilëve u kufizohet e drejta për të kandiduar nga ligji “Për Dekriminalizimin”.<sup>29</sup> Kushtetuta, gjithashtu liston kategoritë e zyrtarëve, postet e të cilëve nuk përputhen me të drejtën për të kandiduar, duke përfshirë zyrtarë të lartë të administratës shtetërore.

Kandidatët mund të propozohen nga partitë politike, koalicionet e tyre ose të kandidojnë në mënyrë të pavarur. Kandidatët e pavarur mund të kandidojnë për zgjedhjet përmes propozimeve të grupeve të zgjedhësve.<sup>30</sup> KQZ-ja përmbushi detyrimet e saj sipas ligjit “Për Dekriminalizimin”, për të verifikuar informacionin që përmbajnë formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve, duke kërkuar të dhëna nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile.<sup>31</sup>

<sup>24</sup> Gjithsej u krijuan 21 qendra të posaçme të votimit në spitale, burgje dhe qendra të paraburgimit.

<sup>25</sup> Votuesit që banojnë jashtë vendit mbeten në listat e zgjedhësve sipas adresës së tyre të fundit të regjistruar.

<sup>26</sup> Kërkesa të tilla mund të bëhen deri në 40 ditë para zgjedhjeve. Që nga kjo periudhë, dhe deri në 24 orë para ditës së zgjedhjeve, kërkesat për ndryshim ose përfshirje në listat e zgjedhësve mund të bëhen vetëm përmes një gjykate të rretheve gjyqësore. Janë paraqitur rreth 600 kërkesa për përfshirje në lista, kryesisht nga të burgosurit.

<sup>27</sup> Afati ligjor për lëshimin e njoftimeve të votuesve ishte 5 mars.

<sup>28</sup> Arsytet për ndryshimet përfshijnë, hapësirat e papërshtatshme ose kërkesat nga pronarët privatë të lokaleve të QV-ve.

<sup>29</sup> Sipas ligjit “Për Dekriminalizimin”, shtetasit e dënuar për krime të caktuara ose të dëbuar, edhe në mungesë të një vendimi të formës së prerë të gjykatës, nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe ato që janë nën një urdhër ndërkombëtar kërkimi, nuk janë të lejuar të kandidojnë për t'u zgjedhur.

<sup>30</sup> Grupet e votuesve duhet të përfshijnë të paktën nëntë votues nga një zonë zgjedhore dhe të regjistrohen në KQZ për të mbledhur nënshkrime të një përqind të votuesve në zonën zgjedhore përkatëse, por jo më shumë se 3,000 nënshkrime.

<sup>31</sup> Ku është e nevojshme, KQZ-ja kërkon verifikim të thellë nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

Listat e kandidatëve të partive jo parlamentare, duhet të mbështeten nga 5000 firma të zgjedhësve në rang kombëtar. Siç kërkohet me ligj, KQZ-ja verifikoi pesë përqind të firmave mbështetëse të paraqitura nga partitë. Ligji është i paqartë se kush mund të vëzhgojë procesin e verifikimit, dhe KQZ-ja rrëzoi kërkesat e anëtarëve të opozitës në KQZ për verifikim shtesë të firmave mbështetëse për pesë parti.<sup>32</sup> Mungesa e mundësive për grupet e tjera të interesit për të ndjekur shqyrtimin e firmave mbështetëse nuk lejon transparencën e plotë të procesit.

Më 7 maj, KQZ-ja përfundoi regjistrimin e listave të kandidatëve të 15 partive.<sup>33</sup> Më 28 dhe 30 maj, pas marrëveshjes politike dhe pa ndonjë ndryshim ligjor në afatet e regjistrimit, KQZ-ja regjistroi gjithashtu listat e kandidatëve të PR-së, Partisë Bashkimi Demokristian dhe PD-së.<sup>34</sup> Në të njëjtën kohë, një kandidati të pavarur të mundshëm iu mohua regjistrimi për shkak të dorëzimit të vonë të dokumentave.<sup>35</sup> Më 5 qershor, partia Forca Rinia aplikoi për regjistrimin e listave të kandidatëve të saj, të cilat u refuzuan nga KQZ-ja me arsyetimin se partia nuk paraqiti gjithë dokumentat e kërkuara brenda afatit ligjor.

Kuotat gjinore aplikohen për çdo listë kandidatësh dhe për përmbushjen e tyre kërkohet që të paktën një grua dhe një burrë të jenë në tre vendet e para, dhe që të paktën 30 përqind e kandidatëve në çdo listë qarku të jenë të gjinisë tjetër. KQZ-ja vendosi sanksione monetare prej 1 milion Lek ndaj listave të LSI -së dhe PS-së, për mosrespektimin e kësaj kërkesë, përkatësisht në qarqet e Tiranës dhe Beratit. Megjithatë, KQZ-ja, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës, nuk vendosi sanksione ndaj PD-së për mosrespektimin e kuotës në të gjitha 12 qarqet e vendit, duke cënuar vlerën e masave për të promovuar kandidatet gra dhe nevojën që partitë të garojnë në baza të barabarta.<sup>36</sup>

Në total, u regjistruan 18 parti politike dhe 2,666 kandidatë, duke përfshirë 1,073 gra (40 përqind). Në përgjithësi, procesi i regjistrimit të kandidatëve, edhe pse gjithëpërfshirës, vuajti nga zbatimi selektiv dhe jo i qëndrueshëm i ligjit, dhe në disa raste ishte i bazuar në marrëveshjen politike dhe jo në ligj.

## Fushata Zgjedhore

Pas ndryshimit të datës së zgjedhjeve, fushata zgjedhore filloi zyrtarisht më 26 maj.<sup>37</sup> Ka pasur aktivitet të rëndësishme të fushatës në të gjithë vendin<sup>38</sup>, edhe pse shikueshmëria ishte e kufizuar për shkak të reduktimit të përdorimit të posterave me madhësi të madhe, flamujve dhe materialeve të tjera

<sup>32</sup> KQZ-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se partitë dhe vëzhguesit nuk kanë të drejtë të ndjekin procesin e verifikimit të firmave mbështetëse dhe se verifikimi kryhet vetëm nga stafi administrativ i KQZ-së. Bazuar në paragrafin I.1.3 të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të vitit 2002 (kontrollimi i firmave duhet të bëhet sipas rregullave të qarta) dhe (procesi i kontrollimit duhet si rregull të përfshijë të gjitha firmat.

<sup>33</sup> Deri atëherë, KQZ-ja mori listat e kandidatëve nga 17 parti politike, 2 prej të cilave (Bashkimi Kombëtar i Shqipërisë dhe Partia Socialiste e Moderuar) nuk i ridorëzuan listat e tyre pas kërkesave të KQZ-së për korrigjime.

<sup>34</sup> Në përputhje me Kodin Zgjedhor, pas caktimit të datës së re të zgjedhjeve, partitë politike duhej të ishin regjistruar jo më vonë se 16 prilli dhe listat e kandidatëve - jo më vonë se 16 maj.

<sup>35</sup> Më 26 maj, KQZ-ja rrëzoi kërkesën e një kandidati të pavarur, i cili paraqiti dokumentat mbështetëse më 25 maj, me arsyetimin se ai humbi afatin e caktuar nga Kodi Zgjedhor.

<sup>36</sup> Paragrafi 3 i Vendimit të Këshillit Ministror të OSBE-së i vitit 2009, 7/09 u bën thirrje shteteve pjesëmarrëse të "inkurajojnë të gjithë aktorët politikë për të promovuar pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në partitë politike, me qëllim arritjen e një përfaqësimi më të mirë dhe të balancuar gjinor në postet publike të zgjedhura". Paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së i vitit 1990 i detyron shtetet pjesëmarrëse, që t'u sigurojnë "partive politike dhe organizatave garancitë e nevojshme ligjore për t'u mundësuar atyre, të konkurrojnë me njëra-tjetrën në bazë të trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe autoriteteve".

<sup>37</sup> Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para dhe mbaron 24 orë para datës së zgjedhjeve.

<sup>38</sup> MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi 120 tubime.



të shtypura të palëvizshme nga të gjithë garuesit.<sup>39</sup> Fushata filloi në mënyrë paqësore, por më vonë ndodhën disa incidente të dhunshme.<sup>40</sup>

Liria e tubimit u respektua dhe partitë dhe kandidatët ishin të lirë të shprehin pikëpamjet e tyre, me fushatat më aktive të zhvilluara nga PD-ja, LSI-ja dhe PS-ja. Një fushatë e dukshme në mbarë vendin është bërë edhe nga PDIU-ja, ndërsa Partia Lista e Barabartë (LIBRA) bëri fushatë kryesisht në qytete. Partitë e tjera ishin prezente vetëm në disa zona.<sup>41</sup>

Gratë ishin aktive, prezente, por të nënpërfaqësuar në fushatë.<sup>42</sup> Disa ngjarje kishin në shënjestër veçanërisht gratë votuese.<sup>43</sup> Kandidatet gra morën pak vëmendjen e mediave; kanalet publike dhe private, të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, i përkushtuan 13 përqind të mbulimit të fushatës për gratë.

Fushata e disa garuesve ishte shumë e personalizuar. Mbizotëron mosbesimi mes partive politike dhe kandidatëve, duke përfshirë shqetësimet e përhapura mbi përfshirjen e kriminelëve në procesin zgjedhor, duke nxitur akuza të ndërsjellta në kurriz të diskutimit të platformave konkrete. Të gjitha partitë kryesore premtuan paga më të larta, standarde më të mira jetese, dhe një luftë të intensifikuar kundër korrupsionit dhe kriminit, duke përfshirë edhe kultivimin e kanabisit, por kishte shumë rrallë zgjidhje konkrete nga politikanët. PS-ja dhe PD-ja u pajtuan publikisht për politikën e nevojshme për procesin e integritetit të Shqipërisë në BE.

Në kuadër të punës së Task Forcës, disa organe shtetërore, kryesisht të kryesuar nga kandidatët e PD-së, pezulluan ose hoqën nga puna disa punonjës të sektorit publik.<sup>44</sup> Disa nga këto shkarkime nuk kishin lidhje të dukshme me procesin zgjedhor dhe disa prej tyre dyshohet se ishin të motivuara politikisht.<sup>45</sup> Ekziston një shqetësim që në një mjedis të institucioneve të politizuara, preferencat zgjedhore të punonjësve të sektorit publik, një segment i ndjeshëm i shoqërisë ndaj presionit, mund të kenë pasojë për jetesën individuale dhe punësimin e ardhshëm. Fushata u dëmtua nga akuza të

<sup>39</sup> Sipas ndryshimeve të 22 majit të ligjit „Për Partitë Politike“, materialet statike të fushatës mund të vendosen jo më larg se pesë metra nga zyrat e fushatës. Këto rregulla u respektuan gjerësisht në të gjithë vendin.

<sup>40</sup> Më 27 maj, PD-ja zhvilloi një tubim në Tiranë, ku morën pjesë disa mijëra njerëz. Pas eventit, MPB-ja deklaroi se 73 persona kërkuan ndihmë mjekësore për shkak të acarimit të syve dhe lëkurës. Më 28 maj, Ministria e Shëndetësisë njoftoi se 140 persona kishin kërkuar ndihmë të parë, 14 prej të cilave ishin shtruar në spital. Hetimi po vijon. Më 14 qershor, në rajonin e Tiranës (Kavajë), tre mbështetës të PD-së u arrestuan për kërcënimin e një anëtari të PS-së. Më 16 qershor, në rajonin e Beratit, kreu i një dege vendore të LSI-së u sulmua nga tre persona, që e kërcënuan me vrasje. Në po të njëjtën ditë, në rajonin e Lezhës, një mbështetës i LSI-së u kërcënuan nga tre burra të armatosur. Më 18 qershor, në rajonin e Durrësit (Fushë Krujë) një aktivist i LSI-së u shtrua në spital pasi u sulmua dhe u rrah nga autorë të panjohur. Më 18 qershor, në rajonin e Shkodrës (Pukë), kryetarët vendorë të LSI-së dhe degës së saj të rinisë u kërcënuan nga koordinatori vendor i PS-së dhe thuhet më vonë nga Policia. Bordi i Disiplinës nuk gjeti asnjë veprim shkelës nga ana e policisë. Më 21 qershor, në Tiranë, një mbështetës i LSI-së u godit me thikë para një lokali, ndërsa ai mëparë u përpoq të hyjë me forcë në një takim të planifikuar ndërmjet zyrtarëve vendorë dhe përfaqësuesve të PD-së. Më 23 qershor, një shpërthim ndodhi para zyrës vendore të LSI-së në Durrës, duke shkaktuar dëme të vogla materiale, por jo viktime. Policia informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se të gjitha rastet e lartpërmendura janë nën hetim.

<sup>41</sup> Përfaqësuesit e disa partive më të vogla, të cilat kishin qenë aleate të PD-së në të kaluarën, u përfshinë në listat e kandidatëve të PD-së dhe e orientuan fushatën e tyre në mbështetje të PD-së.

<sup>42</sup> Asnjë prej kryetarëve të 18 partive, të regjistruara për zgjedhjet, nuk është femër.

<sup>43</sup> Për shembull, tubimet e PS-së në Durrës më 23 maj, në Fier më 26 maj, në Berat më 5 qershor. LSI-ja gjithashtu zhvilloi evente, që kishin si synim gratë, në Kukës më 6 qershor dhe në Dibër më 18 qershor.

<sup>44</sup> Në disa raste, shkarkimet dhe pezullimet nuk u kryen në përputhje me procedurat ligjore. Për shembull, më 2 qershor, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes urdhëroi shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare. Kjo kompetencë duhet të ushtrohet nga Bordi Mbikëqyrës i Postës Shqiptare; më 8 qershor, Ministri i Drejtësisë urdhëroi pezullimin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Ministrie. Sipas ligjit “Për Shërbimin Civil”, kjo kompetencë duhet të ushtrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

<sup>45</sup> Për shembull, më 13 qershor, Ministri i Arsimit dhe Sportit urdhëroi lirimimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë; më 13 qershor, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i kërkoi Departamentit të Administratës Publike të fillojë procedurat për lirimimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë.

ndërsjellta të bëra gjerësisht për blerjen e votave<sup>46</sup>, shqetësimet mbi keqpërdorimin e burimeve shtetërore<sup>47</sup>, dhe të presioneve ndaj zgjedhësve të lidhura me vendin e punës.<sup>48</sup> Këto rrethana minuan besimin e publikut në procesin zgjedhor.

## Financimi i Fushatës

Fushatat zgjedhore mund të financohen nga fondet publike dhe private. Fondet publike u shpërndahen partive për aktivitetet e tyre të rregullta sipas ligjit “Për Partitë Politike”, bazuar në rezultatet e tyre në zgjedhjet e fundit parlamentare. Mjetet publike shtesë ofrohen për qëllime të fushatës për të gjitha partitë që garojnë në zgjedhje.<sup>49</sup> Buxheti i përgjithshëm për financimin e fushatës ishte 65 milionë Lek dhe u shpërnda nga KQZ-JA më 31 maj.<sup>50</sup> Garuesit zgjedhorë, gjithashtu mund të marrin donacione nga qytetarët ose personat juridikë, të marrin kredi ose të përdorin fondet e tyre. Asnjë donacion nuk mund të tejkalojë shumën prej 1 milion Lek, duke përfshirë vlerën ekuivalente për kontributet në natyrë. Të gjitha kontributet mbi 100,000 Lek duhet të bëhen nëpërmjet një llogarie bankare të vecantë.

Kodi Zgjedhor përcakton një limit të shpenzimeve të fushatës që zbatohet për të gjitha partitë, 280 milionë Lek për këto zgjedhje.<sup>51</sup> Në kundërshtim me Kodin, ndryshimet e 22 majit të ligjit “Për Partitë Politike”, autorizuan KQZ-në të përcaktonte një kufi të shpenzimeve për secilën fushatë zgjedhore, por KQZ-ja nuk arriti t’u bënte këtë.<sup>52</sup> Në përputhje me ndryshimet, KQZ-ja hartoi udhëzimet për llogaritjen e kostove të fushatave dhe caktoi ekspertë financiarë për të monitoruar shpenzimet e fushatës së partive politike.

Ligji i ndryshuar “Për Partitë Politike”, ka përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien e financimit të fushatës, duke adresuar disa nga rekomandimet e mëhershme të OSBE/ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës. Kështu, brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve, partitë duhet të bëjnë publike dhe t’i paraqesin KQZ-së një deklaratë financiare të të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të

<sup>46</sup> Derisa ka pasur akuza të përhapura për blerjen e votave në të gjithë vendin, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori konfirmimin nga policia rajonale se kishte ndërmarrë veprime në rastet në vijim: më 17 qershor, policia urdhëroi arrestimin e një individi, i cili dyshohej se u kishte premtuar qytetarëve 10,000 Lek për çdo votë që do t’i jepej një kandidati të caktuar në rajonin e Shkodrës. Më 23 qershor, policia arrestoi në të njëjtin rajon kryetarin e një dege partie dhe një person tjetër, që po shpërndanin paketa ushqimore për të fituar vota. Më 24 qershor, dy burra që ngisnin një makinë me një shumë të madhe parash dhe një kopje të listave të zgjedhësve u arrestuan nga policia në rajonin e Shkodrës. Policia gjithashtu mori raporte për blerjen e votave që përfshinin një kandidat të LSI-së në rajonin e Shkodrës dhe aktivistë të LSI-së në rajonin e Fierit.

<sup>47</sup> Për shembull, përfaqësues të disa partive informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it, që bashkëshortja e një kandidati të LSI-së në Gjirokastrë, gjatë fushatës, përdori subvencione bujqësore për të tërhequr zgjedhësit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi në Fier, Dibër dhe Korçë zyrtarë publikë të PD-së, PDIU-së dhe të PS-së duke marrë pjesë në fushatë zgjedhore gjatë orarit të punës, në tubimet e partive përkatëse. Një tubim i LSI-së në Kukës u ndoq nga punonjës të sektorit publik gjatë orarit të punës. Më 16 qershor, Kryeministri i bëri thirrje policisë dhe mësuesve që të marrin pjesë në tubimet e PS-së jashtë orarit të punës, por kërkoi falje për këtë më vonë.

<sup>48</sup> Për shembull, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua për tre raste të punonjësve publikë të kompanisë OSHEE në Cakran, të cilët u zhvendosën dhe/ose u ulën në pozitë pasi ishin mbështetës të LSI-së. Një përfaqësues i një partie në Fier i tha MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se Kryetari i Bashkisë u kërkoi kompanive publike dhe private të shkarkojnë punonjësit që mbështesin PD-në. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori dy raportime, që PS-ja në Delvine ushtroi presion mbi punonjësit për të marrë pjesë në një tubim dhe mbajtën shënim emrat e stafit të administratës të pranishëm ose atyre që mungonin në festimin e përvjetorit të PS-së.

<sup>49</sup> Partitë që morën më shumë se 0.5 për qind të votave të vlefshme gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare marrin 95 për qind të fondit, në mënyrë proporcionale me numrin e votave të vlefshme të marra. Pjesa e mbetur prej pesë për qind u është shpërndarë partive, që kanë marrë më pak se 0.5 për qind të votave dhe partive që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit.

<sup>50</sup> Këto fonde janë shpërndarë si më poshtë: PS-ja - 28 milion Lek; PD-ja - 20.8 milion Lek; LSI-ja - 7 milion Lek; PR-ja 2 milion Lek; PDIU-ja - 1.8 milion Lek; parti të tjera - ndërmjet 1.2 milion dhe 325.000 Lek.

<sup>51</sup> Sipas Kodit Zgjedhor, një parti politike nuk mund të shpenzojë 10 herë më shumë se shumën më të lartë, që një garues ka marrë nga fondet publike.

<sup>52</sup> Kuptimi i kësaj dispozite mbetet i paqartë.

fushatës. Ekspertët financiarë të sapo emëruar kanë qenë të autorizuar të monitorojnë aktivitetet e fushatës dhe të raportojnë në KQZ brenda katër muajve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. Më 16 dhe 23 qershor, këta ekspertë gjithashtu paraqitën raporte të ndërmjetme për monitorimin e tyre mbi aktivitetet e fushatës në terren, të cilat janë postuar në faqen e internetit të KQZ-së. KQZ-ja mori hapa për të siguruar përputhjen me rregulloret e reja të fushatës në bazë të raporteve të ekspertëve.<sup>53</sup> Megjithatë, mungesa e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese gjatë fushatës, kufizoi transparencën e donacioneve të fushatës.

## Media

Shqipëria ka një klimë mediatike dinamike dhe të tejngopur, duke përfshirë transmetuesit publikë dhe privatë dhe një shumëllojshmëri të mediave elektronike dhe të shkruara, megjithëse interesat ekonomike dhe politike të pronarëve të mediave shpesh ndikojnë raportimet e gazetarëve. Mediat i ofruan elektoratit një gamë të gjerë informacioni dhe opinionesh politike, çka i dha mundësinë zgjedhësve të krahasojnë partitë dhe të bëjnë zgjedhjen e tyre në ditën e zgjedhjeve. Sidoqoftë, mbulimi mediatik i zgjedhjeve shpesh nuk kishte një qasje kritike dhe u përqëndrua më shumë në aktivitetet e partive se sa në analizën e platformave të tyre politike.

Kodi Zgjedhor përmban rregulla të qarta për shpërndarjen proporcionale të minutazhit për të gjithë garuesit zgjedhorë në transmetimet mediatike të lajmeve dhe programe informative, si dhe në mënyrë të ngjashme për mundësinë e fushatës pa pagesë në mediat publike. Ndryshimet në ligjin "Për Partitë Politike" detyrojnë transmetuesit privatë të sigurojnë kohë transmetimi pa pagesë për të gjithë garuesit. Përveç kësaj, ndryshimet në ligj, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, ndaluan transmetimin e reklamave politike me pagesë, duke rezultuar në një zbatim jo të qëndrueshëm të Kodit. KQZ-ja nuk ka marrë asnjë masë për të qartësuar kuadrin ligjor, dhe kanalet televizive private, të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, transmetojnë reklama me pagesë për pesë parti politike (APD, PD, PDIU, LSI dhe PS).

Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) ka monitoruar mediat audiovizive dhe ka dërguar raporte ditore dhe javore në KQZ, të cilat përmbajnë propozime për sanksione administrative.<sup>54</sup> KQZ-ja u kërkoi 27 transmetuesve të korrigjonin brenda 48 orëve mbulimin joproporcional të garuesve, dhe mediat u pajtuan gjerazi me këto kërkesa. Në praktikë, mediat kishin vështirësi në arritjen e mbulimit proporcional të garuesve zgjedhorë, për shkak të intesitetit të ndryshëm të aktiviteteve të fushatës nga partitë më të vogla, kjo u pranua edhe nga BMM-ja.

Rezultatet e monitorimit të mediave, të kryer nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, treguan se mediat u ofruan garuesve mundësinë për të marrë pjesë në debate dhe në biseda televizive.<sup>55</sup> Megjithatë, mbulimi i aktiviteteve të fushatës së partive kryesore politike u krye kryesisht përmes filmimeve të aktiviteteve të fushatës, shpesh të përgatitura dhe të dërguara në media nga partitë. Në kundërshtim me rekomandimet e OSBE-së dhe standardeve të Këshillit të Evropës, Kodi Zgjedhor ofron ende mundësinë për të përdorur informacionet e përgatitura nga garuesit zgjedhorë në lajme, çka mund të

<sup>53</sup> Për shembull, më 15 qershor, KQZ-ja i kërkoi Kryetarit të Bashkisë së Durrësit të hiqte materialet nga vendet e paautorizuara.

<sup>54</sup> Që prej 26 majit, BMM-ja nisi monitorimin e 13 operatorëve audiovizivë që transmetonin nga Tirana dhe 25 operatorëve që transmetonin nga 8 rajone. BMM-ja dorëzoi 28 raporte ditore dhe 4 javore, duke u kërkuar 27 mediave kombëtare dhe lokale, që të sigurojnë një kompensim mbulimi, dhe kërkoi të sanksionohen 7 media.

<sup>55</sup> MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka bërë monitorimin e një kampioni mediatik me analiza sasiore dhe cilësore të mbulimit të tyre politik, në veçanti: transmetimet në orët me shikueshmëri më të lartë (18:00 deri 24:00) të pesë kanaleve televizive (transmetuesi publik *RTSH* dhe katër kanaleve private: *ABC News*, *Top Channel*, *TV Klan* dhe *Vizion Plus*), një gazetë ditore nga shtypi i shkruar (*Panorama*) dhe tre portale online (*balkanweb.com*, *gazetatema.net* dhe *syri.net*).

cënojë autonominë editoriale të transmetuesve.<sup>56</sup> Pozitive vërehet, marrja e një vendimi nga KQZ-ja më 1 qershor, ku sqarohet se kanalet private të radios dhe të televizionit nuk janë të detyruara të transmetojnë materialin e dërguar nga partitë në edicionet e tyre të lajmeve; por nëse pranohen, këto materiale duhet të identifikohen qartë me logon e partisë. Jo të gjitha kanalet televizive private, në mënyrë të qëndrueshme dhe të qartë, identifikuan me logo materialet e dërguara nga partitë, por kjo nuk u pasqyrua në raportet e BMM-së. Minutazhi dedikuar analizave të hollësishme ishte shumë i kufizuar. Nuk u zhvilluan debate midis kryetarëve të partive kryesore.

Në të gjitha kanalet televizive të monitoruara, mbulimi i fushatës u fokusua kryesisht në aktivitetet e tri partive kryesore. Garuesit zgjedhor, me përjashtim të PD-së, LSI-së dhe PS-së, shprehën shqetësime rreth minutazhit të tyre të kufizuar në mediat elektronike. Transmetuesi publik *RTSH*, në përputhje me ligjin, u siguroi të gjithë garuesëve kohë transmetimi pa pagesë. Në programet e saj të lajmeve dhe informimit, *RTSH* shpërndau 25 përqind kohë mbulimi për PD-në, 24 përqind për PS-në dhe 19 përqind për LSI-në; toni i mbulimit ishte kryesisht asnjëanës ose pozitiv. Ndërkohë që një mbulim më i balancuar u vërejt në *Vizion Plus*, *ABC News* shpërndau 37 përqind të mbulimit për PD-në, 28 përqind për PS-në dhe 21 për qind për LSI-në, ku toni ishte përgjithësisht gjithashtu asnjëanës ose pozitiv. Në *TV Klan* (për të gjitha partitë kryesore) është vërejtur një mbulim paksa më kritik, i cili i dedikoi 42 përqind të mbulimit të tij PS-së, 24 përqind PD-së dhe 17 përqind LSI-së. Një mbulim i ngjashëm u vërejt në *Top Channel*, i cili shpërndau 42, 33 dhe 16 përqind të mbulimit respektivisht për PS-në, PD-në dhe LSI-në; por toni i mbulimit për PD-në ishte pjesërisht negativ. Më 24 dhe 25 qershor, gjatë periudhës të heshtjes zgjedhore disa kanale televizive transmetuan një konferencë për shtyp të LSI-së.

Për sa i përket mediave të tjera, gazeta *Panorama* favorizoi PD-në (40 përqind e hapësirës dedikuar mbulimit të fushatës) në dëm të PS-së dhe LSI-së (përkatësisht 32 dhe 20 përqind), kryesisht me një mbulim asnjëanës dhe pozitiv për të gjithë garuesit. Ndërmjet portaleve të internetit të monitoruara, *balkanweb.com* siguroi një mbulim të balancuar për garuesit kryesor. Ndërsa *gazetatema.net* mbuloi në mënyrë të barabartë PD-në dhe PS-në (37 përqind të prezencës në faqen e saj të internetit për secilën), 44 për qind e informacionit mbi PD-në ishte në tone negative. Nga ana tjetër, *syri.net* ishte në favor të PD-së (47 për qind me një mbulim gjerësisht asnjëanës dhe pozitiv), ndërsa PS-së i dha 34 për qind kohë mbulimi, e cila në gati një të tretën e përmbajtjes ishte në tone negative.

## Ankesat dhe Apelimet

Kodi Zgjedhor parashtron një procedurë ankimore administrative kundër vendimeve të KZAZ-së dhe ankesë gjyqësore kundër vendimeve të KQZ-së. Megjithatë, përgjegjësia për ankesat për shkeljet e rregulloreve të fushatës është e paqartë. Disa KZAZ informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se do të shqyrtonin çdo ankesë në lidhje me shkeljet e fushatës, ndërsa të tjerë besonin se vetëm KQZ-ja ishte e autorizuar ta bënte këtë.<sup>57</sup> Përfaqësuesit e partive politike treguan se preferonin të publikonin ankesat e tyre në media si një mjet për të kërkuar mbështetje për shkak të besimit të ulët në efektivitetin e mekanizmave formalë të ankesave. Pak ankesa lidhur me fushatën janë bërë para ditës mosë zgjedhjeve.<sup>58</sup>

Vendimet e KZAZ-ve mund të ankimohen në KQZ nga garuesit. Asnjë ankesë e tillë nuk është bërë para ditës së zgjedhjeve. Vëzhguesit vendorë mund të ankimojnë vendimet e KQZ-së dhe KZAZ-së

<sup>56</sup> Shiko paragrafin 9.1 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së dhe paragrafin 26 të Dokumentit të Moskës të 1991. Shiko gjithashtu paragrafin I.3 të Rekomandimeve të Këshillit të Evropës CM/Rec (2007)15, e cila shprehet se “Kuadri rregullator për mbulimin mediatic të zgjedhjeve duhet të respektojë pavarësinë editoriale të medias.”

<sup>57</sup> Sipas KQZ-së, KZAZ-të nuk kanë autoritet për të trajtuar ankesat lidhur me zgjedhjet parlamentare.

<sup>58</sup> Kur bëhen ankesat, ato shpesh u janë drejtuar njëkohësisht autoriteteve të ndryshme. Për shembull, një ankesë e PD-së më 6 qershor në Diber për mosrespektimin e rregulloreve të fushatës nga PDIU-ja i është drejtuar KZAZ-së, Kryetarit të Bashkisë dhe Policisë. Në Gjirokastrë, më 12 qershor, PD-ja u ankua për shkelje të rregulloreve të fushatës nga PS-ja dhe LSI-ja në Polici dhe KZAZ.

lidhur me akreditimin e tyre. Vendimet e KQZ-së për miratimin e rezultateve të zgjedhjeve, fillimisht ankimohen pranë vetë KQZ-së. KQZ-ja duhet të vendosë për ankesat në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve brenda 10 ditëve nga paraqitja e tyre, por afati nuk është specifikuar qartë për llojet e tjera të ankesave.<sup>59</sup> Procedura e ankimit administrativ në KQZ është e hollësishme dhe përfshin caktimin e një relatori, verifikimin paraprak, seancë rishikuese, dhe pranueshmërinë për çdo kërkesë ankimore

Vetëm garuesit mund të ankimojnë vendimet, veprimet dhe mosveprimet nga ana e KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë. (Kolegji Zgjedhor).<sup>60</sup> Qëndrimi i kufizuar për të sjellë ankesa, mund të lërë grupet e prekura të interesit pa ndonjë mjet juridik mbrojtës.<sup>61</sup> Apelimet në Kolegjin Zgjedhor gjykohen nga një panel prej pesë gjyqtarësh, i cili në çdo rast zgjidhet me short. Një numër i kufizuar i apelimeve lidhur me zgjedhjet janë bërë pranë Kolegjit Zgjedhor para ditës së zgjedhjeve, kryesisht në lidhje me regjistrimin e kandidatëve.<sup>62</sup> Kolegji Zgjedhor ka respektuar afatin 10-ditor për gjykimin e ankesave, por vendimet e tij nuk janë zbardhur gjithmonë brenda periudhës së kërkuar 3-ditore. Janë respektuar të drejtat procedurale të palëve dhe vendimet janë arsyetuar, edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme.<sup>63</sup> Vendimet e kolegjit zgjedhor janë të formës së prerë.

### Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare

Kushtetuta e Shqipërisë garanton të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat kombëtare, dhe garanton të drejtën e votës dhe të drejtën për të kandiduar në zgjedhje për të gjithë qytetarët, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike, racës, përkatësisë fetare apo gjuhës. Pjesëtarë të pakicave kombëtare janë kandiduar si për partitë e minoriteteve si për ato të përgjithshme.

Zhvillimi i fushatës në gjuhët e pakicave kombëtare është i lejuar, dhe fushata publike, në dy gjuhë greke dhe maqedonase janë vërejtur pa incidente. Asnjë nga kandidatët e pakicave kombëtare nuk shprehu shqetësim lidhur me përdorimin e gjuhës së tyre, madje edhe përmes mediave audiovizive.<sup>64</sup>

Nuk janë vërejtur incidente me rëndësi, që tregojnë për tensione etnike ose diskriminim kundër komuniteteve të pakicave kombëtare. Disa zgjedhës nga komuniteti Rom ende përballen me pengesa praktike në lidhje me regjistrimin e zgjedhësve, për shkak të faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë mungesën e dokumentacionit zyrtar dhe mospasjen e një rezidence fikse. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së pranuan se praktika e blerjes së votave është një problem i rrënjosur në zonat me popullsi të

<sup>59</sup> Sipas KQZ-së, afati prej 10 ditësh zbatohet për të gjitha ankesat.

<sup>60</sup> Kolegji Zgjedhor është i përbërë nga tetë gjyqtarë të zgjedhur me short, për katër vjet, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit në Shqipëri. Kolegji Zgjedhor aktual u krijua në dhjetor të 2016-së dhe përfshin një gjyqtarë femër.

<sup>61</sup> Paragrafi II.3.3.f i Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias shprehet se të “gjithë kandidatët dhe të gjithë zgjedhësit e regjistruar në zonën zgjedhore në fjalë duhet të ketë të drejtën të ankohen”.

<sup>62</sup> Kolegji Zgjedhor shqyrtoi gjithsej nëntë ankesa, tri prej të cilave u vendos se ishin jashtë juridiksionit të tij (lidhur me heqjen e mandateve për deputet sipas ligjit “Mbi Dekriminalizimin” dhe shpërblimin e Sekretarit të KZAZ-së), ndërsa pesë të tjera kishin të bënin me regjistrimin e kandidatëve. Një apelim nga LSI-ja kishte të bënte me emërimin e grupeve të numërimit.

<sup>63</sup> Kolegji Zgjedhor vendosi që një parti politike, e cila u regjistrua për zgjedhje, por që nuk paraqiti listat e kandidatëve, nuk kishte interes të ligjshëm për të ankimuar regjistrimin e listave të PD-së dhe PR-së, duke shmangur rishikimin gjyqësor të regjistrimit sipas marrëveshjes politike. Një kandidat i pavarur, i cili pretendoi se mund të regjistrohesh edhe në bazë të marrëveshjes politike, u refuzua. Gjykata u shpreh se PDIU-ja duhet të konsiderohet në opozitë, me qëllim emërimin e grupeve të numërimit, ndërsa në vitin 2015 Kolegji Zgjedhor vendosi që PDIU-ja ishte pjesë e shumicës qeverisëse.

<sup>64</sup> Partia MEGA, e vetmja parti e pakicave kombëtare në fletë votimi, që përfaqëson një pakicë kombëtare me një gjuhë amtare ndryshe nga ajo shqipe, e përdori kohën e transmetimit pa pagesë në *RTSH* gjysëm në gjuhën shqipe dhe gjysëm në gjuhën greke.

madhe të pakicave Rome dhe Egjiptiane, si edhe në zonat rurale apo në zonat e tjera të pafavorizuara ekonomikisht.<sup>65</sup>

Çështjet e pakicave kombëtare u përmendën deri diku në fushatat e partive të mëdha, të cilat kërkonin të tërhiqnin zgjedhësit e këtyre komuniteteve. Zhgënjimi politik në komunitetet Rome dhe Egjiptiane mbetet i lartë, sepse në perceptimin e tyre premtimet e bëra nga kandidatët gjatë fushatave të mëparshme nuk janë mbajtura. Partia më e madhe e pakicave greke dhe ajo e pakicave maqedonase, secila, zgjodhën të mbështesin partitë e përgjithshme, në vend që të garonin vetë.<sup>66</sup>

KQZ-ja ka prodhuar postera dhe fletëpalosje me informacione për zgjedhësit në gjuhët greke, maqedonase, rome, serbe dhe vllehe/arumune. Gjithashtu, KQZ-ja bëri disa përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin e zgjedhësve në komunitetin Rom.

### Vëzhguesit Vendorë dhe Ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar në të gjitha fazat e zgjedhjeve, por vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë nuk kanë të drejtë të marrin kopje të protokolleve të rezultateve nga VNV-të dhe KZAZ-të. Një hap pozitiv ishte detyrimi që KQZ-ja i vuri KZAZ-ve, që të afishojnë publikisht protokollin e rezultateve të numërimit në ambientet e VNV-ve. Partitë garuese, organizatat vendore dhe ndërkombëtare kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues në çdo KZAZ, KQV dhe VNV; megjithatë, vetëm partitë kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues për çdo tavolinë numërimi. Partitë parlamentare mund të emërojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, ndërsa partitë e tjera kanë të drejtë të emërojnë përfaqësues për të marrë pjesë në seancat e KQZ-së vetëm për periudhën zgjedhore.

Autoritetet u bënë ftesë disa grupe vëzhguesish ndërkombëtarë. Akreditimi i vëzhguesve ishte gjithëpërfshirës dhe KQZ-ja ka akredituar gjithsej 541 vëzhgues ndërkombëtarë dhe 3,731 vëzhgues vendorë.

### Dita e Zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve u zhvillua në një sfond akuzash për blerje votash dhe incidentesh të raportuara dhe të aplifikuara nga media. Në mesnatë, KQZ-ja njoftoi pjesëmarrjen paraprake të zgjedhësve në 45 përqind. Në përpjekje për tu dhënë të gjithë zgjedhësve kohën për të hedhur votën e tyre, KQZ-ja zgjati votimin me një orë shtesë.

Hapja u vlerësua negativisht në 16 përqind të vëzhgimeve, një e dhënë e rëndësishme. Shumica e qendrave të votimit të vëzhguara u hapën vonë (63 përqind), kryesisht për shkak të mungesës së komisionerëve apo njohurive të pakta procedurale të komisionerëve, gjë që tregon për mungesën e një trajnimit të duhur. MNVZ-ja vëzhgoi 11 raste të ndërhyrjes në proces nga vëzhguesit e partive.

Dita e zgjedhjeve vazhdoi në mënyrë të rregullt, edhe pse u raportuan raste të dhunës. Votimi u vlerësua negativisht në 7 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara. Janë vërejtur disa shkelje të rënda procedurale. Kjo përfshinte kontrollin e zgjedhësve për gjurmët e bojës (25 përqind të vëzhgimeve) dhe markimi me bojë i zgjedhësve (13 përqind), të cilat janë masat mbrojtëse kryesore kundër votimit të shumëfishtë. Votimi në emër të personave të tjerë u vërejt në pesë përqind të vëzhgimeve dhe

<sup>65</sup> Një përfaqësues i Romëve i raportoi MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se aktivistët e PDIU-së në Fier po kontaktonin zgjedhës derë më derë, duke u treguar atyre se për kë duhet të votonin në fletën e votimit, dhe u ofruan 10.000 Lek në këmbim të kartës së identitetit, të cilat do tu riktheheshin në afërsi të QV-së atyre zgjedhësve të cilët kishin premtuar të tregonin një foto të fletës së tyre të votimit të markuar.

<sup>66</sup> PBDNJ-ja bashkoi forcat me PD-në: Kryetari i PBDNJ-së pranoi një pozicion me rëndësi në listën e PD-së në Vlorë dhe një tjetër anëtar i PBDNJ-së u përfshi në listën e PD-së në Korçë. Aleanca Maqedonase për Integrim European vendosi të mbështesë LSI-në me një kandidat të sajën në listën e LSI-së në Korçë.

nënshkrime të ngjashme u vëzhguan në pesë për qind të vëzhgimeve. Rastet e votimit në grup u vërejtën në 11 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Ndërsa transparencja vlerësohet në mënyrë pozitive, për shkak të pranisë të një numëri të lartë të vëzhguesve të partive (95 për qind), vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm vetëm në 17 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara.

Tensione ose shqetësime u vërejtën në katër për qind të qendrave të votimit. Në afërsi të qendrave të votimit u vëzhguan grupe aktivistësh të partive, të cilët shpesh dukeshin se udhëzonin zgjedhësit për kë të votonin. Vëzhguesit e MNVZ-së vunë re shumë raste, ku vëzhguesit e partive mbajtën shënim personat që kishin votuar, duke regjistruar numrat e tyre rendorë, siç janë caktuar në listat e zgjedhësve. Ky proces u ndihmua nga komisionerët, të cilët thërrosnin me zë të lartë numrin rendor të zgjedhësve. Në pesë për qind të vëzhgimeve, MNVZ-ja vërejtë individë që tentonin të influenconin zgjedhësit, për të votuar për një parti të caktuar.

Në 27 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, zgjedhësve iu mohua e drejta për të votuar, kryesisht për arsye legjitime dhe u drejtuan në qendrat e tjera të votimit. Ky ishte tregues i impaktit të ndryshimeve të vonuara të vendeve të qendrave të votimit dhe publikimit të vonuar të listave të zgjedhësve.

Vëzhguesit ishin në gjendje të ndiqnin procesin pa kufizime në pothuajse të gjitha qendrat e votimit dhe në përgjithësi u bë e mundur transparencja. Vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në 95 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara dhe ishin kryesisht nga PS-ja, PD-ja dhe LSI-ja. Ndërhyrjet në proces nga persona të paautorizuar janë vërejtur nga MNVZ-ja në pesë për qind të vëzhgimeve.

Më shumë se dy të tretat e qendrave të votimit të vëzhguara nuk kishin vende kalimi të veçanta për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, ndërsa paraqitja e brendshme e qendrës së votimit nuk ishte e përshtatshme në 35 për qind të vëzhgimeve. Sekretet e votës mund të ishte komprometuar në 4 për qind të qendrave të votimit të vizituara, për shkak se vendet e votimit ishin të papërshtatshme për kryerjen e votimit (4 për qind) ose të mbipopulluara (6 për qind) dhe për shkak të organizimit të dobët (29 për qind).

Mbyllja u vlerësua negativisht në 17 për qind të vëzhgimeve, kryesisht për shkak të tensioneve (11 për qind e vëzhgimeve). Disa procedura kryesore nuk janë ndjekur, duke përfshirë këtu numërimin e nënshkrimeve në listën e zgjedhësve (9 për qind) ose fletët e votimit të papërdorura (10 për qind). Njohja me procesin nga anëtarët e KQV-së u vlerësua negativisht në 12 për qind të rasteve. Transferimi i materialeve drejt VNV-ve u vlerësua pozitivisht.

Numërimi nuk filloi menjëherë pasi marrjes së të gjitha materialeve nga qendrat e votimit dhe pushimet, shpesh të zgjatura, u vëren në 29 nga 42 VNV-të e vëzhguara. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se disa grupe numërimi ishin ende duke u emëruar dhe trajnuar në natën e zgjedhjeve. Procesi i numërimit po vazhdon në të gjitha VNV-të e vëzhguara. Transparenca e procesit ishte shpesh e kufizuar, për shkak se vëzhguesit ishin vendosur shumë larg tavolinave të numërimit; grupet e numërimit jo gjithmonë ekspozonin fletën e votimit në kamera në mënyrën e duhur (të cilët shfaqnin fletën e votimit në një ekran të madh në VNV); por, nganjëherë edhe për shkak të cilësisë së dobët të pajisjeve të përdorura për të shfaqur fletën e votimit në ekran.

---

## INFORMACION MBI MISIONIN & FALENDERIME

---

Tiranë, 26 qershor 2017 – Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake është rezultat i një nisme të përbashkët që përfshin Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), Asamblenë Parlamentare të OSBE-së (AP-ja e OSBE-së), Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) dhe Parlamentin Europian (PE). Vlerësimi u bë për të përcaktuar nëse zgjedhjet ishin në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet e Këshillit të Evropës, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin kombëtar.

Z. Roberto Battelli u emërua nga Kryetari në Detyrë i OSBE-së si Koordinator i Posaçëm dhe udhëheqës i misionit vëzhgues afatshkurtër të OSBE-së. Znj. Marietta Tidei kryesoi delegacionin e AP-së së OSBE-së. Z. Paolo Corsini kryesoi delegacionin e APKE. Z. Eduard Kukan kryesoi delegacionin e PE-së. Ambasadori Peter Tejler është Kreu i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, të vendosur në Shqipëri që prej 8 majit.

Secila nga institucionet e përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, ka miratuar Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të 2005-së. Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake nxirret para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet pjesërisht nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave ose apelimeve të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR-i do të nxjerrë një raport përfundimtar gjithëpërfshirës, duke përfshirë rekomandimet për përmirësime të mundshme, rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Asambleja Parlamentare e OSBE-së do të paraqesë raportin e saj në takimin e Komitetit të Përhershëm në Minsk në korrik 2017. APKE-ja do të paraqesë raportin e saj në Komitetin e saj të Përhershëm në tetor të 2017-së në sesionin parcial në Strasburg. PE-ja do të paraqesë raportin e saj në mbledhjen e Komitetit e Punëve të Jashtme në korrik 2017.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it përfshin 15 ekspertë në kryeqytet dhe 26 vëzhgues afatgjatë të vendosur në të gjithë vendin. Në ditën e zgjedhjeve u vendosën 327 vëzhgues nga 43 vende, duke përfshirë 255 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të vendosur nga OSBE/ODIHR-i, si dhe një delegacion i Asamblesë Paralametare të OSBE-së i përbërë nga 34 anëtarë, një delegacion me 25 anëtarë nga APKE-ja, dhe një delegacion me 11 anëtarë nga PE-ja. Hapja e procesit të votimit u vëzhgua në 135 QV dhe votimi u vëzhgua në 1300 QV në të gjithë vendin. Numërimi dhe nxjerrja e rezultateve u vëzhgua në 42 VNV dhe KZAZ.

MNVZ-ja dëshiron të falënderojë autoritetet për ftesën e tyre për vëzhgimin e zgjedhjeve, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën. Ata gjithashtu shprehin vlerësimin e tyre për institucionet e tjera shtetërore, partitë politike, median, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasadori Peter Tejler, Kreu i MVZ-së së OSBE/ODIHR, në Tiranë (+355 44 541 850);
- Thomas Rymer, Zëdhënësi i OSBE/ODIHR +355 69 759 3402 ose +48 609 522 266), ose Alexey Gromov, Këshilltar për Zgjedhjet i OSBE/ODIHR, në Varshavë (+48 663 910 311);
- Nat Parry, AP e OSBE-së, +45 60 10 81 77;
- Bogdan Torcatoriu, APKE, +355 68 585 9602 ose +33 650 39 29 40;
- Tim Boden, PE, +355 69 685 6189 ose +32 473 52 5072

### **Adresa e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it:**

Rruga Fuat Toptani, Nr.3, 1011 Tiranë, Republika e Shqipërisë  
Tel: + 355 44 541 850; Fax: + 355 44 541 851, Email: office@odihr.al

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.  
Një përkthim jozyrtar është i disponueshëm në gjuhën shqipe.*